

V E N D I M
Nr.443, datë 26.6.2003

PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS E TË NIVELEVE TË PAGAVE TË PUNONJËSVE TË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË UJËSJELLËS-KANALIZIMEVE, INSTITUTIT TË STUDIMEVE DHE PROJEKTIMEVE URBANISTIKE DHE ARKIVIT QENDROR TEKNIK TË NDËRTIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2 dhe 5 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat e caktimit të pagave të punës”, i ndryshuar dhe të nenit 8 të ligjit nr.8983, datë 20.12.2002 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2003”, me propozimin e Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit dhe të Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Struktura dhe nivelet e pagave në Drejtorinë e Përgjithshme të Ujësjellës-Kanalizimeve të jenë sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 2. Struktura dhe nivelet e pagave në Institutin e Studimeve dhe të Projekttimeve të Urbanistikës të jenë sipas lidhjes nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 3. Struktura dhe nivelet e pagave në Arkivin Qendror Teknik të Ndërtimit të jenë sipas lidhjes nr.3, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 4. Paga e grupit (kolona 1) e lidhjeve 1, 2, 3, diplomë e shkollës së lartë, është 9 000 (nëntë mijë) lekë.
 5. Shtesa për vjetërsi në punë (kolona 2) e lidhjeve 1, 2, 3 jepet në masën 2 për qind pas çdo viti pune, deri në 25 vjet dhe llogaritet mbi pagën e grupit.
 6. Shtesa për kualifikim (kolona 3) e lidhjeve 1, 2, 3 është 0.
 7. Shtesa për pozicion është sipas kolonës 4 të lidhjeve 1, 2, 3.
 8. Paga për punonjësit e tjerë të Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjellës-Kanalizimeve, të Institutit të Studimeve e Projekttimeve të Urbanistikës dhe të Arkivit Qendror Teknik të Ndërtimit të jetë sipas lidhjes II/M “Paga për punonjësit e ministrive, institucioneve të tjera qendrore, ATSH-së, prefekturave dhe Shërbimit Gjeologjik Shqiptar” të vendimit nr.726, datë 21.12.2000 të Këshillit të Ministrave “Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore”, i ndryshuar.
 9. Vendimi nr.587, datë 5.12.1994 i Këshillit të Ministrave “Për pagat e punonjësve të Arkivit Qendror Teknik të Ministrisë së Ndërtimit, Strehimit dhe Rregullimit të Territorit”, shfuqizohet.
 10. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi të përballohen nga buxheti i vitit 2003, zëri “Fond page”, miratuar për Ministrinë e Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit.
 11. Ngarkohet Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.7.2003.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

Lidhja nr.1

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË UJËSJELLËS-KANALIZIMEVE

Emërtimi	Paga mujore			
	Paga individuale			Shtesa e pozicionit
	Paga e grupit	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)

	(PG)			
	1	2	3	4
Drejtor i Përgjithshëm i DPUK-së	9 000	2%	0	90 000
Nëndrejtor i Përgjithshëm i DPUK-së	9 000	2%	0	74 000
Drejtor drejtorie	9 000	2%	0	55 000
Shef sektori	9 000	2%	0	40 000
Specialist	9 000	2%	0	20 000

Lidhja nr.2

**STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E INSTITUTIT TË
STUDIMEVE DHE PROJEKTIMEVE TË URBANISTIKËS**

Emërtimi	Paga mujore			
		Paga individuale		Shtesa e pozicionit
	Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)
	1	2	3	4
Drejtor i ISPU	9 000	2%	0	74 000
N/Drejtor i ISPU	9 000	2%	0	55 000
Shef sektori	9 000	2%	0	40 000
Përgjegjës grupi	9 000	2%	0	30 000
Specialist	9 000	2%	0	20 000

Lidhja nr.3

**STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E ARKIVIT TEKNIK TË
NDËRTIMIT**

Emërtimi	Paga mujore			
		Paga individuale		Shtesa e pozicionit
	Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)
	1	2	3	4
Drejtor i AQTN	9 000	2%	0	74 000
N/Drejtor i AQTN	9 000	2%	0	55 000
Shef sektori	9 000	2%	0	40 000

Specialist	9 000	2%	0	20 000
------------	-------	----	---	--------